



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, më datë: 12.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 106/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashkrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **08.06.2023** të parashtruar nga: **“AWA SH.P.K. dhe Offishop Group SH.P.K. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Furnizim i shkollave me ditar për nxënës “ , me nr.identifikues 651-23-4630-1-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 044 121 nxjerr:**

V E N D I M

Refuzohen – kërkesat për ri-shqyrtim të **“AWA SH.P.K. dhe Offishop Group SH.P.K. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Furnizim i shkollave me ditar për nxënës “ , me nr.identifikues 651-23-4630-1-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 044 121** të datës **23.05.2023** kundër **Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë - të datës 23.05.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. **AK - Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë të datës 23.05.2023.**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

“AWA SH.P.K. dhe Offishop Group SH.P.K. me datë 23.05.2023, kanë parashtruar kërkesat e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Furnizim i shkollave me ditar për nxënës “ me nr.identifikues 651-23-4630-1-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 044 121. Autoriteti Kontraktues me datë 12.06.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga "AWA SH.P.K dhe Omshop Group SH.P.K. „Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara :

Pretendimi ankimor i parë :

Kriteri nr.2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional

Kërkesa 2. Operatori Dëshmia 2.Operatori Ekonomik

Eltonomik duhet te posedoj duhet të posedoj Autorizimin e Autorizimin e prodhuesve të prodhuesit per shperndarje dhe ditareve nga shtëpitë distribuim.Botuese (Libri Shkollor dheDukngjini) sipas normavedhe Ligjeve ne fuqi.Ne jemi informuar që MINISTRIA për vitin e ri shkollor 2023-2024 e ka autorizuar vetëm shtepinë botuese „DUKAGJINI“ per shperndarjen e ditareve andaj kerkojmë nga ju që te merreni informatë ose të ndryshohet në DT qe OE te posedon „AUTORIZIMIN E DITARËVE“. Ne e kemi si informate pas dates se cekur si afat i fundit per ankesa dhe sqarime ne DT. Mirpo sipas mendimeve tona na duket se eshte e padrejte per te tjeret sepse automatikisht te gjithë jemi te eliminuat nga OE dhe poashtu ne kete menyre demtohet edhe buxheti i KK Gjilanit.Ne poashtu kontaktuam edhe me shtepine botuese “Libri Shkollor” e cila na tregoi qe ditaret per kete vit ende nuk i kane gati dhe nuk briten ti botojne per kete vit. Kurse “Dukagjini” na informoi qe ende nuk ka nje autorizim final per te gjithë ditaret shkollor dhe pritet qe kete muaj ne Qershor te kete autorizimin e vetmja shtepi botuese per shperndarjen e ditareve.

Pretendimi ankimor i Dytë :

Kriteri nr.2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional

Eshte kriter diskriminues dhe eliminon te gjithë OE te interesuar per kete aktivitet te prokurimit

Ne kemi komunikuar shtepin botuese Libri Shkollor na njofton se Autorizimet nuk mund te jau leshojme sepese nuk i posedojn ditaret ende OE, ndersa ne baz te informatav qe i kem per vitin 2022-2023 te drejten per shperndarjen e ditareve e posedon vetem shuepia botuese Dukagjini prandaj mendojm qe duhet te ndryshohet DT

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet te posedoj Autorizimin e prodhuesve të ditareve nga shtëpitë Botuese (Libri Shkollor dhe Dukagjini) sipas normave dhe Ligjeve ne fuqi.

Dëshmia 2. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dëshmi se posedon Autorizimin e prodhuesit për shpërndarje dhe distribuim.

Përgjigja rreth Pretendimit ankimor të parë dhe dytë :

Ne si AK -- Autoritet Kontraktues duke u bazuar në Vendimin e MASHTT-ut Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), si dhe në bazë të neneve 26, 27 dhe 28 të Udhëzimit Administrativ nr.8/2012 Dokumentacioni shkollor parauniversitar , ka nxjerr Vendimin Për lejimin e botimit dokumentacionit pedagogjik-shkollor. Ku, si arsytim duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, kërkesës me nr. 1264 dt.08.06.2022, për lejimin e botimit të dokumentacionit pedagogjik-shkollor për vitin shkollor 2022/2023 dhe nevojës që dokumentacioni pedagogjik shkollor të botohet me kohë, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

Rrjedhimisht, AK -- Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë të datës 23.05.2023 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.